



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:126715
Datë: 16.09.2024
Numri i dokumentit: 06164539

Ac.nr.6942/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryetar i kolegjit, Frosina Sylejmani e Besnik Feka - anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.L., nga fshati..., komuna e Ferizajit, të cilin me autorizim e përfaqëson av.A.D., nga Ferizaji, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si dhe Zyra e Kryeministrit - Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - departamenti i përgjithshëm, C.nr.1670/21, të datës 01.09.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **16.09.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si dhe Zyra e Kryeministrit - Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - departamenti i përgjithshëm, C.nr.1670/21, i datës 01.09.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.1670/21, të datës 01.09.2022, në pikën **I (një)** të dispozitivit e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit A.L. nga fshati..., komuna e Ferizajit, si dhe e ka detyruar të paditurën Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si dhe Zyra e Kryeministrit - Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar material si pasojë e të reshurave atmosferike - breshërit, t'ia paguake shumën e përgjithshme prej 11,900.00€. Në pikën **II (dy)** të dispozitivit, është detyruar e paditura që paditësit në emër të demit material dhe jo material t'ia paguaj shumat e gjykuara si në dispozitivin nr.I të këtij aktgjykimi, të gjitha këto shuma me kamatë vjetore prej 8% duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë, e deri në pagesën

definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 775.00€, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë, më gjerësisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor, e paditura ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të *shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, me propozim që aktgjykimi i goditur me këtë ankesë të ndryshohet dhe të refuzohet në tërësi kërkesëpadia, ose i njëjti të kthehet në rigjykim.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar pala paditëse, me propozim që ankesa e palës së paditur të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet në tërësi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e palës së paditur është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datë 21.06.2021, në Gjykatën Themelore në Ferizaj, ka ushtruar padi kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me seli në Prishtinë, me kërkesë që të detyrohet e paditura që në emër të dëmit të shkaktuar në drithëra, të shkaktuar si pasojë e breshëritë t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 3.200€, si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, ka mbajtur shqyrtimin kryesor dhe ka administruar provat e paraqitura nga palët ndërgjyqëse dhe atë: vendimi me numër 01/58 datë 24.07.2018, Raporti i vlerësimit nr.11, datë 11.05.2018, si dhe pas vlerësimit të tyre e ka miratuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera gjykata e shkallës së parë ka cekur se pas administrimit dhe vlerësimit të provave të propozuara ka vërtetuar faktin se më datë 05.05.2018 komunën e Ferizajit e përfshiu një rrebesh shiu i përcjell me breshër duke i shkaktuar dëme të mëdha në kulturat bujqësore paditësit dhe si rezultat i këtyre paditësit i është shkaktuar dëm, fakte këto të cilat sipas nen.173 dhe 183 të LMD-së paraqesin bazë për kompensimin e dëmit. Se paditësit A.L. i është shkaktuar dëm nga të reshurat këtë fakt gjykata e vërtetoi nga raporti i vlerësimit nr.11 datë 05.06.2018, ky fakt nuk ishte kontestues mes palëve ndërgjyqëse. Nga Raporti i vlerësimit i datës 05.06.2018, komisioni i formuar nga Komuna e Ferizajit prej tre anëtarëve kanë dalur në teren dhe kanë konstatuar nga reshjet e shkaktuara nga shiu dhe breshëri fermerit A.L. i është shkaktuar dëm në shumë prej 11,900.00€. Me vendimin me nr.01/58 të datës 24.07.2018 Qeveria e Republikës së Kosovës ka marr vendim ku në pikën e 1 të këtij vendimi përcakton se “ *për kompensimi ne menjëhershëm të dëmeve të shkaktuara nga breshëri në Komunitat e Kosovës*”, ndërsa në pikën 6 të këtij vendimi përcaktohet se “Vendimi hyn në

fuqi ditën e nënshkrimit”, andaj edhe është krijuar baza për kompensimin e dëmit nga neni 185 dhe 173 të LMD-së. Gjykata i analizoi theksimet e të autorizuarit të paditësit, i cili i propozoj gjykatës që ta miratoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit duke theksuar se shumata e kërkuara si në precizim të kërkesëpadisë janë në harmoni me dëmet e shkaktuara në kulturat bujqësore nga të fatkeqësitë natyrore, sepse paditësit kanë pësuar dëme në kulturat bujqësore pa fajin e tyre, përgjegjëse për të mbuluar dëmin është e paditura dhe ka obligim të përmbushjes së detyrimeve dhe po ashtu shtoi se kërkesëpadia është në përputhje të plotë me dispozitat e LMD-së dhe se si e tillë duhet të miratohet në tërësi, e këtyre theksimeve gjykata pjesërisht ua dha besimin e plotë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjykata i analizoi edhe theksimet e të autorizuarit të paditurës në përgjigje në padi, i cili i propozoj gjykatës që kërkesë padinë e paditësve ta refuzoj si të pa themeltë, pasi që e paditura nuk është fajtorë e shkaktimit të dëmit dhe për të patur përgjegjësinë mbi dëmin organet e shtetit duhet që dëmin ta shkaktojnë vet, këto theksime gjykata nuk i morri si të bazuara e të cilat kishin të bënin lidhur me së kompensimin e dëmit, pasi vet Kryeministri i Republikës së Kosovës e ka nënshkruar vendimin me të cilën do të kompensohen fermerët për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga breshëri, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) i LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës për shkeljet që i referohen konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, e as shkeljeve të tjera nga neni 182.2, pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160, par. 4 dhe 5 të LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktgjykimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra tjetrën. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë (sikurse në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit), e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontest, në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Kështu, gjykata e shkallës së parë, në arsyetim të aktgjykimit ka paraqitur arsye të mjaftueshme për bazën juridike të kërkesëpadisë dhe shumën e aprovuar në emër të kompensimit të dëmit sikurse në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur për shkeljet që i referohen gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, pasi që gjykata e shkallës së parë

me rastin e vendosjes lidhur me të drejtën materiale, me të drejtë është bazuar në Raporti i vlerësimit i datës 11.05.2018, komisioni profesional i formuar nga Komuna e Ferizajit prej tre anëtarëve kanë dalur në teren dhe kanë konstatuar nga reshjet e shkaktuara nga shiu dhe breshëri fermerit A.L. i është shkaktuar dëm në shumë prej 11,900.00€, pasi që të njëjtit në masën 70% i është dëmtuar sipërfaqja e mbjellë me dredhëza prej 0.35 ha. Në anën tjetër, është vlerësim i gjykatës së shkallës së dytë se është i pranueshëm dhe i drejtë qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë në lidhje me vërtetimin e bazës juridike të kërkesëpadisë së paditësit. Në lidhje me këtë, gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit me të drejtë është bazuar në vendimin me nr.01/58, të datës 24.07.2018, i marr nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ku në pikën e 1 të këtij vendimi përcaktohet shprehimisht se *“për kompensimi në menjëhershëm të dëmeve të shkaktuara nga breshëri në Komunat e Kosovës”*, ndërsa në pikën 6 të këtij vendimi përcaktohet se *“Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit”*, pra ky vendim ka qenë në fuqi në kohën kur ka pas reshje dhe breshër, andaj edhe është krijuar baza për kompensimin e dëmit nga neni 185 dhe 173 të LMD-së. Andaj, përderisa e paditura nuk ka vepruar konform vendimit të cekur më lartë për të kompensuar dëmin e pësuar nga paditësi në pronën e tij për shkak të dëmtimit të kulturës bujqësore nga breshëri i rënë me datë 05.05.2018, në Komunën e Ferizajit, përkatësisht edhe në pronën e paditësit, atëherë paditësit i ka lindur e drejta që kërkesën e tij ta realizoj përmes procedurës gjyqësore.

Në lidhje me pretendimet ankimore të palës së paditur se nuk ka qenë kompetencë e Komunës së Ferizajit për të bërë përlllogaritjet e dëmit, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se të njëjtat janë të pabazuara. Kjo për faktin se ngastrat kadastrale është në Komunën e Ferizajit dhe sipas rregullave ligjore në fuqi është në detyrimin e Komunës së në bazë të kërkesës së qytetarëve të dalë në terren dhe të evidentojë demet e shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore (siç është në rastin konkret rënia e breshrit dhe dëmi i shkaktuar nga i njëjti). Përveç kësaj, e paditura i ka pasur të gjitha mundësitë ligjore që përmes përgjigjes në padi apo në seancën gjyqësore të mbajtura, të propozoj gjykatës nxjerrjen e provave të ndryshme, përfshirë këtu edhe kryerjen e ndonjë ekspertize, mirëpo siç rezulton nga shkresat e lëndës e njëjta nuk e ka bërë një gjë të tillë, përkatësisht e paditura përkundër thirrjes me rregull nuk ka marr pjesë në seancë. Gjithashtu vlerësohet i pabazuar edhe pretendimi tjetër ankimor i të paditurës për mungesën e legjitimitetit real pasiv dhe mos ndarjen buxhetore për qëllimin e kompensimit të dëmit të pretenduar nga paditësi. Kjo për faktin se është vet e paditura, e cila përmes nxjerrjes së vendimit nr.01/58, të datës 24.07.2018, ka marr për detyrim kompensimin e menjëhershëm të dëmeve të shkaktuara nga breshëri, për çka edhe e njëjta legjitimohet për të qenë palë në këtë procedurë. Ndërsa është në kompetencë të vet të paditurës që përmes planifikimit dhe ndarjes buxhetore të përmbushë detyrimet financiare në raport me detyrimet e marra përsipër përmes vendimeve të saj.

Gjykata e Apelit vlerëson se edhe vendosja e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me shpenzimet e procedurës është e drejtë dhe e ligjshme, pasi që është në përputhje me dispozitën e nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të palës së paditur, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.6942/22, datë 16.09.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Arsim Hamzaj